

“ZERI” 30/05/2009

30/05/2009

Zeri. E shtunë, 30 maj 2009

Hapen mundësi të reja për studentët kosovarë

Kosova dhe Austria bashkëpunojnë në dy pro- grame të reja master në UP

Menaxhimi shëndetësor është programi i parë që do ta realizojë Fakulteti i Mjekësisë në bashkëpunim me Universitetin Mjekësor të Vjenës dhe Mekatronika është masteri tjetër që realizohet nga Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike dhe ai i Inxhinierisë Mekanike në UP si në bashkëpunim me Universitetin e Gracit



dje është bërë edhe nënshkrimi i kontratës mes UP-së dhe WUS Austria

Tetori do të jetë muaji kur studentët kosovarë do të kenë mundësinë të regjistrohen edhe në dy programe të reja të nivelit master në Universitetin e Prishtinës (UP): Menaxhim shëndetësor, program që zhvillohet në Fakultetin e Mjekësisë, dhe Mekatronikë, ku do të bashkëpunojnë Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike dhe ai i Inxhinierisë Mekanike.

Për këtë ngjarje të rëndësishme, dje është bërë edhe nënshkrimi i kontratës mes UP-së dhe WUS Austria, organizatë e cila është duke udhëhequr këtë program, qëllimi i të cilit është të lehtësojë transicionin e institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë në drejtim të përbushjes së standardeve europiane.

But Dedaj, nga WUS Austria, bëri të ditur se këto studime do të fillojnë në tetor të këtij viti dhe aty do të mund të pranohen vetëm nga 25 studentë në secilin drejtim.

Ai po ashtu tha se programet do të realizohen në bashkëpunim me dy universitete austriake: Universitetin e Mjekësisë në Vjenë dhe atë të Gracit.

Ndërsa, rektori i UP-së, Enver Hasani, falënderoi shtetin austriak për ndihmën që i ka dhënë vazhdimi i arsimit kosovar, sidomos arsimit të lartë publik në realin e shtetit.

Bolonjës.

“Universiteti i Prishtinës do ta përdorë këtë ndihmë dhe dëshiron të sigurojë partnerët austriakë se ne do të bëjmë më të mirën në këtë drejtim”, tha ai.

Programi për Zhvillim të Studimeve Master përkrahë fakultetet e interesuara të Universitetit të Prishtinës në zhvillimin e programeve master në bazë të nevojave të tregut të punës dhe kuadrot e të cilave janë më se të nevojshme për këtë treg në Kosovë. Ky program jep mundësinë e zhvillimit të kurrikulës së re në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë të Austrisë si dhe në bashkëpunim me institucionë, organizata dhe biznese vendore.

Prandaj, theks i veçantë i vihet përkrahjes strategjike në zhvillimin e programeve master të cilat përgjenëdrohen në kërkosat e tregut të punës, të cilat rezultojnë në zbatimin praktik të dijenisë, bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë të Austrisë dhe efekti i kthimit të trurit (Brain Gain).

Këto master-programe do të zhvillohen në gjuhën angleze dhe ka indikacione se do të kemi edhe diplomatë para të përbashkëta që do të lëshohen me universitetet austriake.